



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 391/10 Prot.

Tiranë, më 23-02. 2026

V E N D I M

Nr. 26 dt. 23-02 2026

**“PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR NDALIMIN E PIRJES SE DUHANIT NË  
AMBIENTET E UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në nenin 3, pika 4 gërma a), nenin 38 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, në Vendimin nr.57, datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7 pika 4, gërma a), nenin 20 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, në shkresën nr.146/1 prot. datë 29.01.2026 “Relacion mbi hartimin e draft-rregullores “Për ndalimin e pirjes së duhanit në ambientet e Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 23.02.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores “Për ndalimin e pirjes së duhanit në ambientet e Universitetit të Sporteve të Tiranës” (bashkëlidhur vendimit).
2. Ky vendim ti përcillet për njohje, zbatim dhe publikim të gjitha njësive përbërëse të UST-së dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Sherbimeve Akademiko-Shkencore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK  
Prof. Dr. Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
REKTORATI

Nr. 225/2 Prot.

Tiranë, më 30.01 2026

V E N D I M

Nr. 23 dt. 30.01 2026

“PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR NDALIMIN E PIRJES SE DUHANIT NË  
AMBIENTET E UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS”


Mbështetur në nenin 3, pika 4 gërma a), nenin 40 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, në Vendimin nr.57, datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7 pika 4, gërma a), nenin 25 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, në nenin 11 të Rregullores së UST-së, në shkresën nr.146/1 prot. datë 29.01.2026 “Relacion mbi hartimin e draft-rregullores “Për ndalimin e pirjes së duhanit në ambientet e Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Rektorati në mbledhjen e datës 30.01.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores “Për ndalimin e pirjes së duhanit në ambientet e Universitetit të Sporteve të Tiranës” (bashkëlidhur vendimit).
2. Ky vendim i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KASA



**RREGULLORE**  
**“PER NDALIMIN E PIRJES SË DUHANIT NË AMBIENTET E**  
**UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS”**

**Neni 1**

**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i masave për ndalimin e pirjes së produkteve të duhanit në ambientet e Universitetit të Sporteve të Tiranës, me qëllim:

- a) mbrojtjen e shëndetit të studentëve, stafit dhe vizitorëve;
- b) parandalimin e ekspozimit të pavullnetshëm ndaj tymit të duhanit;
- c) krijimin e një mjedisi universitar të shëndetshëm, të sigurt dhe dinjitoz;
- d) rritjen e ndërgjegjësimit mbi dëmet shëndetësore që shkaktojnë produktet e duhanit.

**Neni 2**

**Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet dhe zbatohet në mbështetje të:

- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”;
- Ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar;
- Statutit dhe Rregulloreve të Universitetit të Sporteve të Tiranës;

**Neni 3**

**Subjektet**

1. Subjekte të kësaj rregulloreje janë:

- a) studentët;
- b) stafi

- d) kontraktorët/shërbimet e jashtme;
  - e) vizitorët dhe çdo person tjetër që ndodhet në territorin e Universitetit.
2. Çdo subjekt është i detyruar të respektojë ndalimet dhe detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore.

#### Neni 4

##### Përkufizime

1. "Pirje duhani" është ndezja, thithja dhe mbajtja në dorë e ndezur e çdo produkti duhani, si dhe e cigares elektronike e shishave/nargjileve.
2. "Produkte të ngjashme" përfshijnë cigaret elektronike, pajisjet me ngrohje, si dhe çdo pajisje tjetër që çliron aerosol/tym që mund të ndikojë tek personat përreth.
3. "Ambiente universitare" janë të gjitha hapësirat e administruara, të përdorura apo të shfrytëzuara nga Universiteti, përfshirë ndërtesat, sallat, laboratorët, palestrat, oborret dhe hapësirat e përbashkëta.
4. "Sinjalistikë" janë shenjat informuese (postera, tabela, sticker) të vendosura në pika të dukshme, që njoftojnë ndalimin e pirjes së duhanit.
5. "Monitorim" është procesi i vëzhgimit dhe verifikimit periodik të zbatimit të rregullores.
6. "Raportim" është njoftimi zyrtar i një shkeljeje, nëpërmjet kanaleve të përcaktuara në këtë rregullore.

#### Neni 5

##### Fusha e zbatimit

Kjo Rregullore zbatohet për sigurimin dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe studentëve të UST-së, në të gjitha godinat ku e shtrin aktivitetin e tij Universiteti i Sporteve të Tiranës duke u udhëhequr nga parimi trajtimit të barabartë për marrjen e masave për mbrojtjen e sigurisë e të shëndetit në punë.

#### Neni 6

##### Detyrimet e universitetit

Universiteti i Sporteve ka detyrimin të:

- Vendosë sinjalistikë të dukshme me mbishkrimin“NDALOHET DUHANPIRJA” në të gjitha ambientet;
- Informojë studentët dhe stafin për përmbajtjen e kësaj rregulloreje;
- Nxisë fushata ndërgjegjësuese për jetesë të shëndetshme dhe sport pa duhan;
- Të caktojë personat përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kësaj rregulloreje;

#### **Neni 7**

##### **përsonat përgjegjës**

1. Pranë Rektoratit të UST dhe çdo njësie kryesore caktohet personi përgjegjës;
2. Personat përgjegjës kanë këto detyrime:
  - Vendosjen e sinjalistikës së nevojshme;
  - Monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të rregullores;
  - Dhënien e masave këshilluese;
  - Raportimin e shkeljeve në përputhje me këtë rregullore

#### **Neni 8**

##### **Zona të përcaktuara**

Universiteti përcakton zona të posaçme të hapura jashtë ndërtesave, të largëta nga hyrjet/dritaret dhe me sinjalistikë përkatëse.

#### **Neni 9**

##### **Detyrimet e subjekteve**

Çdo person që ndodhet në ambientet e universitetit është i detyruar:

- Të respektojë ndalimin e duhanpirjes;
- Të mos pengojë zbatimin e kësaj rregulloreje;
- Të raportojë shkeljet pranë strukturave përgjegjëse të universitetit.

## **Neni 10**

### **Informimi i studentëve**

1. Universiteti garanton informimin e studentëve mbi këtë rregullore në mënyrë të vazhdueshme dhe të aksesueshme.
2. Informimi realizohet përmes:
  - a) publikimit në faqen zyrtare të Universitetit dhe kanalet zyrtare të komunikimit;
  - b) njoftimeve në ambientet universitare (postera/tabela);
  - e) aktiviteteve ndërgjegjësuese me karakter edukues.

## **Neni 11**

### **Roli i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët**

1. Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët (DMJPS) koordinon informimin, komunikimin dhe ndërgjegjësimin lidhur me këtë rregullore.
2. DMJPS:
  - a) përgatit dhe shpërndan njoftime zyrtare;
  - b) administron publikimet në kanalet zyrtare;
  - c) shërben si pikë kontakti për pyetje/sugjerime/ankesa;
  - d) organizon komunikim periodik me përfaqësues studentorë;
  - e) përgatit raporte informuese mbi ndërgjegjësimin dhe materialet e përdorura.

## **Neni 12**

### **Monitorimi**

1. Monitorimi kryhet periodikisht nëpërmjet vëzhgimeve në terren dhe verifikimeve të sinjalistikës.
2. Personat përgjegjës bashkëpunojnë me stafin dhe studentët për koordinimin e procesit të monitorimit.

## **Neni 13**

### **Raportimi i shkeljeve**

1. Raportimi bëhet nëpërmjet informimit ose ankesës:

- a) me njoftim te personi përgjegjës;
- c) me ankesë në përputhje me rregulloret e brendshme të UST

#### Neni 14

##### Masat disiplinore

1. Masat synojnë ndalimin e shkeljes, parandalimin e përsëritjes dhe ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm.
2. Masat ndaj shkelësve mund të përfshijnë:
  - Këshillim
  - Tërheqje vëmëndje
  - Në rastet e përsëritura ndaj shkelësve mund të fillojë procedimi disiplinor në përputhje me Kodin e Etikës.

#### Neni 15

##### Masat administrative

1. Shkeljet e dispozitave të percaktuara në ligjin Nr.9636, datë 06.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
  - a. 300.000 lekë personi i tatueshëm.
  - b. 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, personi përgjegjës në institucionet publike;
  - c. 5 000 lekë (pesë mijë) lekë, duhanpirësi;
2. Masa e gjobes parashikohet si dënim më vete dhe jepet nga trupat inspektuese.

#### Neni 16

##### Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati Akademik dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit.

2.Strukturat përgjegjëse ngarkohen me publikimin dhe komunikimin e rregullores, si dhe me koordinimin e fushatës informuese fillestare.

#### **Neni 17**

#### **Dispozita kalimtare**

Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi, vendosen të gjitha sinjalistikat e nevojshme dhe realizohet komunikimi orientues për studentët dhe stafin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
GRUPI I PUNËS PËR HARTIMIN E DRAFT RREGULLORES

Nr. 146/1 Prot.

Tiranë, më 29 .01.2026

Lënda: Relacion mbi hartimin e draft-rregullores “Për ndalimin e pirjes së duhanit në ambientet e Universitetit të Sporteve të Tiranës”

REKTORIT TË UST  
PROF. DR. AGRON KASA

*I nderuar Z.Rektor,*

Mbështetur në Urdhrin e Rektorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës Nr. 4, datë 19.01.2026, “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e rregullores ‘Për ndalimin e pirjes së duhanit në ambientet e Universitetit të Sporteve të Tiranës’”, dhe në zbatim të misionit të Universitetit të Sporteve të Tiranës për garantimin e një mjedisi akademik të shëndetshëm, të sigurt dhe dinjitoz për studentët, stafin dhe vizitorët, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, grupi i punës i ngritur për këtë qëllim, pas një procesi konsultimesh, ka hartuar draft rregulloren “Për ndalimin e pirjes së duhanit në ambientet e Universitetit të Sporteve të Tiranës”.

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e masave të qarta dhe të detyrueshme për ndalimin e pirjes së produkteve të duhanit, në të gjitha ambientet universitare të administruara apo të përdorura nga UST. Qëllimi i saj është mbrojtja e shëndetit publik, parandalimi i ekspozimit pasiv ndaj tymit të duhanit, si dhe forcimi i kulturës institucionale për një jetë të shëndetshme dhe sport pa duhan.

Rregullorja mbështetet në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, Ligjin nr. 9636/2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, Statutin dhe Rregulloret e Universitetit të Sporteve të Tiranës.

Në përmbajtjen e saj, rregullorja përcakton:

- subjektet që i nënshtrohen zbatimit të saj;
- fushën e zbatimit dhe përkufizimet përkatëse;
- detyrimet e universitetit dhe të subjekteve;
- rolin e strukturave përgjegjëse për informim, monitorim dhe raportim;
- masat disiplinore dhe administrative në rast shkeljeje;
- procedurat e informimit dhe hyrjen në fuqi të saj.

Miratimi i kësaj rregulloreje do të kontribuojë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës universitare, në respektimin e standardeve ligjore dhe në forcimin e imazhit institucional të UST-së si një universitet që promovon shëndetin, sportin dhe mirëqenien.

#### GRUPI I PUNËS PËR HARTIMIN E DRAFT RREGULLORES

Lindita Cakoni - Përgjegjës Sektori në DIJZHK

Enerjada Xhindole - Përgjegjës Sektori në DMJPS

Besmira Karagjozi - Përgjegjës Sektori në DBNJ

Kryetar

Anëtar

Anëtar